



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:115834

Datë: 04.01.2024

Numri i dokumentit: 05157281

CN.nr.165/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin **Florian Krasniqi**, në çështjen juridike të propozueses J.D me vendbanim në "...", duke vepruar sipas propozimit për pranimin - njohjen e vendimit të Gjykatës së shtetit të huaj, jashtë seancës me datë 04.01.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i propozueses J.D. me të cilin ka kërkuar që të njihet vendimi i Gjykatës Themelore në Jogodinë, i datës 22.01.2020 me numër "...", i plotëfuqishëm me datë 22.01.2020, me të cilin është zgjidhur martesë, ndërmjet propozueses J.D., e lindur me "...", në Prishtinë dhe M.D i lindur me datë "...", në Prishtinë.

A r s y e t i m

Propozuesja J.D. nga "...", me datën 07.06.2022 ka paraqitur propozim për njohje të vendimit të huaj përkatësisht për pranim - njohje të vendimit të Gjykatës Themelore në Jogodinë, i datë 22.01.2020 me numër "...", me të cilin sipas thënieve në propozim, është zgjidhur martesë ndërmjet propozueses J.D. e lindur me "...", në Prishtinë dhe M.D i lindur me datë "...", në Prishtinë.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës konstaton se propozuesja, së bashku me propozimin për njohje të vendimit të huaj, si provë ka bashkëngjitur vendimin e datës 22.01.2020 me numër "...", në origjinal, si dhe kopjet e përkthyer në gjuhën shqipe të këtij vendimi. Po ashtu, propozuesja ka paraqitur edhe Certifikatën e martesës të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Graçanicë e dt.11.07.2018 me nr. Reference: "...", dhe numër rendor: 74.

Gjykata pas analizimit të provave të lartë cekura, erdhi në përfundimin se propozimi për njohje të vendimit të huaj i paraqitur nga propozuesja është i pabazuar. Kjo për faktin se, fillimisht propozuesja në propozimin për njohje të vendimit të huaj, i është referuar faktit se me vendimin njohjen e të cilin e kërkon, është zgjidhur martesë në mes të propozueses dhe kundërpropozuesit, e cila martesë është lidhur me 22.04.2018 dhe e njëjta martesë është regjistruar në regjistrin e martesave për zonën amtare të llapnasellës, si dhe martesës e cila është zgjidhur me vendimin njohjen e të cilit kërkon, i referohet si martesë me numër rendor 3. Po ashtu, në dispozitivin e

vendimit 22.01.2020 me numër “...” njohja e të cilit kërkohet, konstatohet se është zgjidhur martesë e cila është e regjistruar në regjistrin e martesave që mbahet për zonën amtare të Llapnasellës, nën numrin rendor 3, për vitin 2018 ndërmjet propozueses J.D dhe kundërpropozuesit M.D.

Bazuar në konstatimet si më lartë, Gjykata vlerëson se, të dhënat për martesën e zgjidhur, të cilat janë cekur në vendimin e Gjykatës Themelore në Jogodinë sipas të cilit propozuesja J.D dhe M.D kanë zgjidhur martesën, nuk përputhet me numrin dhe të dhënat nga certifikata martesore e palëve, ashtu që përderisa në vendimin e Gjykatës Themelore në Jogodinë është cekur se është zgjidhur martesë e cila është lidhur në mes palëve të lartë cekura me dt: 22.04.2018 me numër rendor 3, e lidhur në zonën amtare në Llapnasellë, ndërsa nga certifikata e martesës e bashkangjitur në shkresat e lëndës vërehet që palët kanë lidhur martesë me datë 11.07.2018 në zyrën e gjendjes civile në Graçanicë, certifikata me numër të referencës “...” dhe me numër rendor 74.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në vendimin e lartë cekur, nuk është vendosur për zgjidhjen e martesës sipas regjistrin civil i cili ekziston në Republikën e Kosovës, në të cilat regjistra edhe është regjistruar martesë.

Po ashtu në hyrje të vendimit njohja e të cilit kërkohet, gjykata e cila e ka lëshuar vendimin kur ka shënuar adresën e propozueses, i është referuar se adresa e propozueses është: Ugljare, Komuna e Fushë Kosovës, K dhe M, e që sipas vlerësimit të kësaj Gjykate ky emërtim nuk i referohet emrit zyrtar të Republikës së Kosovës.

Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se, bazuar në nenet 160 deri 165 të Ligjit numër 08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me nr. 30 të datës 05.09.2022 në Prishtinë, gjegjësisht neni 165 i këtij ligji i cili përcakton: *Vendimi i huaj gjyqësor, nuk njihet, nëse efekti i njohjes së tij dukshëm është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Kosovës*, nuk janë plotësuar kushtet për pranimin e këtij vendimi dhe në përputhje me nenin 170 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CN.nr.165/2022, datë 04.01.2024

Gjyqtari,
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.